



K.DH.SH.II.nr.1042/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Krenar Berisha, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A. (KES/CO), me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2311/18 të datës 18.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 09.03.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditëses Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A. (KES/CO), me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2311/18 i datës 18.03.2021, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2311/18 të datës 18.03.2021, është refuzuar si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses, Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A. (KES/CO), me të cilën ka kërkuar që të anulohet si i kundërligjshëm vendimi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji në Prishtinë me numër V_1024_2018, i datës 20.08.2018, si e pabazuar.

Kundër aktgjykimit të lartcekur në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditëses, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të

gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit si e bazuar, të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2311/18 i datës 18.03.2021 si i pabazuar dhe të miratohet kërkesëpadia e paditësit KES/CO Sh.A, ashtu që anulohet vendimi i ZRRE-së nr.DMK-V_1024_2018 i datës 20.08.2018, si i pabazuar.

I autorizuari i të paditurës, Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë, në përgjigje në ankesë ka propozuar që ankesa e paditësit të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Kolegji i kësaj gjykate shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi për konflikt administrativ në gjykatë me datën 24.09.2018, kundër vendimit të paditurës Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë, me nr.V_1024_2018 të datës 20.08.2018, me të cilin është refuzuar ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin B.Z.G., me shifër të konsumatorit DPR-..., si e pabazuar dhe ka mbetur në fuqi vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr..ZRRE/DMK_V_1835_07_18 i datës 26.07.2018.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditëses paraqitur kundër vendimit të lartcekur të Zyrës së Rregullatorit për Energji në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin me të cilin kërkesëpadinë e paditëses e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetim se për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar gjykata iu referua nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatori e Energjisë, ku përcaktohet se: *“1.5 të sigurojë se tarifat e rregulluara për aktivitetet të energjisë janë të arsyeshme dhe të vendosura në bazë të një metodologjie tarifore të përshtatshme të thjeshtë e të lehtë duke e përfshirë sigurimin e tarifave*

për sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes, adekuate për ta mundësuar kryerjen e investimeve të domosdoshme në sisteme, në mënyrë që këto investime të garantojnë qëndrueshmëri të sistemeve; 1.8. të sigurojë mbrojtjen e konsumatorëve dhe të licencuarve me rregulla adekuate për zgjidhje të kontesteve; 1.9. të sigurojë se interesat në mes konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të energjisë balancohen në mënyrë adekuate dhe se mbrohen konsumatorët në nevojë; 1.10. të veprojë në pajtim me vendimet relevante me efekt obligues ligjor të institucioneve të krijuara në Komunitetin e Energjisë, në rastet kur këto institucione janë të mandatuara për të marrë vendime të tilla me efekt obligues ligjor”; Po ashtu gjykata iu referua edhe Rregullores për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji të nxjerr nga ZRRE në muajin prill të vitit 2017, nenit 5 paragrafi 1.5 ku përcaktohet se: *“konsumatorët kanë obligim që të paguajnë energjinë e shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuar nga ZRRE”*. Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe shkresave të lëndës di dhe duke i'u referuar dispozitave në këtë vendim, konstatohet se sipas rrjedhës së energjisë elektrike të konsumatorit vërehet se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën para datës 02/2014-12/2015 është 1,134.65kwh për muaj, për periudhën 02/2016-12/2017 është 1,352.67kwh, kurse për periudhën 04/2016-09/2016 janë 1,744.83kwh për muaj. Kur kemi parasysh periudhën 10/2014-03/2015 shpenzimet janë 1,331.67kwh për muaj, kurse për periudhën 10/2016-03/2017 janë 2,013.17kwh për muaj, andaj rrjedhimisht për muajin 01/2016 nuk ka përputhshmëri referuar gjendjes nëpër muaj të shpenzimeve të energjisë nga konsumatori. Gjykata duke ju referuar edhe procesverbalit datë 19.04.2016 ku konstatohet nën pikën 1 se njëtori elektrik nuk është në rregull, konstatimi është JO dhe se në vërejtje po ashtu konstatohet se njëtori elektrik është pa pllombë ndarës të tensionit, andaj rrjedhimisht konstatohet se për muajin 01/2016 kemi faturim të pa bazë.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 9 dhe 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, në përgjigje në padi, provave të

administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, drejtë ka vendosur kur ka refuzuar kërkesëpadinë paditësit si të pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata në mënyrë të mangët ka bërë konstatimin e gjendjes faktike, e në këtë mënyrë nxjerr përfundime të gabuara, e mbi këtë bazë nxjerr aktgjykimin kontestues jo në pajtim me dispozitat ligjore. Pastaj ka potencuar se gjykata duhet ta gjejë të vërtetën materiale, e vërteta materiale është ajo e vërtetë që ekziston faktikisht në jetën reale që në fakt është si e tillë, me qëllim të vërtetimit të së drejtës materiale organi duhet të vërtetojë të gjitha faktet dhe rrethanat që janë relevante për nxjerrjen e një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm. Me tej pohon se gjykata nuk ka bërë një analizë të plotë të fakteve dhe rrethanave të çështjes duke mos i marrë për bazë faktet dhe provat e paraqitura nga ana e palës paditëse të cilat provat e kanë argumentuar në mënyrë profesionale të kundërtën e vendimit të ZRRE-së. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, kjo për faktin se konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditëses ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditëses në padi janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe gjykata e shkallës së parë. Pra, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka gjetur se organi i paditur ka analizuar faktet e rastit, dëshmitë dhe argumentet e paraqitura nga palët, andaj, pranë një gjendje të tillë faktike kolegji i kësaj gjykate konsideron se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kurse, sa i përket pretendimeve ankimore të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale se krahasimi i shpenzimeve të energjisë elektrike para dhe pas periudhës kontestuese, nuk mund të konsiderohet real pasi që dallimi i shpenzimeve në këto periudha është mbi 40%, për gjykatën nuk qëndron duke pasur parasysh arsyetimet e ZRRE-së të cilët kanë analizuar me kujdes shpenzimet e energjisë elektrike para dhe pas periudhës kontestuese dhe ka vërtetuar se mesatarja mujore e

shpenzimeve të energjisë elektrike para dhe pas periudhës, te ky konsumator është pothuajse konstante (02/2014-12/2015 është 1,134.65kwh për muaj dhe 02/2016-12/2017 është 1,676.61kwh për muaj). Edhe pas analizimit dhe krahasimit të faturave vetëm për muajin janar për periudhat 2015, 2016, 2017 dhe 2018 është vërtetuar se as për së afërmi nuk është me shpenzimin e faturuar të muajit 01/2016 prej 8,452kwh dhe nuk përputhet me gjendjen reale të shpenzimit të energjisë elektrike që bënë konsumatori, pasi që shpenzimi i energjisë elektrike para dhe pas kësaj periudhe kontestuese është pothuajse i njëjtë. Ndërsa sa i përket pretendimit që sipas procesverbalit të kalkulimit njehsori elektrik nr.1301674787 është brenda kufijve të lejuar të matjes dhe se gabimi në matje është -0.38% dhe mund të konstatohet se fatura e muajit 01/2016 është reale, mirëpo për Gjykatën ky konstatim duke marrë të cekurat nga procesverbali është vërejtur se njehsori elektrik nuk është në rregull dhe kanë theksuar se njehsori elektrik është pa bllombë të ndarësit të tensionit ku punëtorët e autorizuar të kalibrimit nuk kanë dhënë detaje se për çka nuk është në rregull njehsori elektrik dhe se pse njehsori elektrik është pa bllombë të ndarësit të tensionit, kur dihet se përgjegjës i njehsorit elektrik është Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sipas nenit 54 të Ligjit për Energji Elektrike, si dhe duke u bazuar në nenin 5 prag. 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*, atëherë mund të konstatojmë se në rastin konkret konsumatori ka pasur obligim që të paguaj për atë që ka shpenzuar, por që jo të ngarkohet pa bazë me një vlerë shumë të lartë e cila ka mund të jetë për shkak të problemeve teknike në njehsorin elektrik. Andaj lidhur me këtë ZRRE ka konstatuar se konsumatori duhet të shkarkohet nga fatura e muajit 01/2016 në vlerë financiare prej 812.73€ për shkak të faturimit të pabazë dhe për këtë muaj KESCO duhet të ngarkoi konsumatorin me shpenzimet e energjisë elektrike si të muajit 01/2017(TL=1975këh dhe TU=883këh). Ky kolegji këto pretendime ankimore thekson se janë të pa qëndrueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa, nga arsyeja se nuk janë të argumentuara me asnjë provë, dhe si të tilla nuk kanë ndikim në konstatimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo që kanë vërtetuar organi i paditur dhe gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale, është aplikuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditëses.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditëses dhe lënies në fuqi të vendimit të lartpërmendur, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditëses u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1042/22, me datë 09.03.2023

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**